Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 463-753/1
Data Datum Date 05.11.2020

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Bekim Jashari**, Kryetar i Komunës së Skenderajt<br>**Fatbardha Haliti**, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Goran Rakić**, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL-së<br><br>**Rozafa Ukimeraj**, Sekretare e Përgjithshme e MPL-së | |
| Nga: | **Venera Çerkini**, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Data: 27.10.2020<br>Nr. 463-753 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br><br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | <br>**Xhevat Tafa**, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br><br>**Vjosa Ahmetaj**, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave | |
| Lënda: | Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Skenderajt | |
| Lloji i aktit: | □ Rregullore e Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Rregullore e Kuvendit të Komunës Nr.01-110/01-0042575/20 për dhënien në shfrytëzim deri në një (1) vit të pronës, objekteve, lokaleve dhe hapësirave publike në Komunën e Skenderajt |
| I miratuar më datë: 29.09.2020 |
| I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 05.10.2020 |

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson së akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi**.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

| Nr. | Formulimi në aktin e komunës | Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim |
|---|---|---|
| 1. | Rregullore Nr. 01-110/01-0042575/20 për dhënien në shfrytëzim deri në një (1) vit të pronës, objekteve, lokaleve dhe hapësirave publike në Komunën e Skenderajt | Rregullore Nr. 01-110/01-0042575/20 për dhënien në shfrytëzim deri në një (1) vit të pronës, objekteve, lokaleve dhe hapësirave publike në Komunën e Skenderajt është në kundërshtim Ligjin Nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës. |
| | Neni 5. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale deri në një (1) vit | Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale deri në një (1) vit krahas Ligjit Nr. 06/L-092 duhet të bëhet edhe në pajtim me Rregulloren Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës. Të përfshihet paragrafi 1 i Nenit 7 të Rregullores. |
| | Neni 11. Kohëzgjatja e kontratës do të bëhet në afat prej (1) viti e jo më pak së një (1) me mundësi vazhdimi për një (1) vit tjetër nëse për pronën objektin, lokali apo hapësirës publikë në kohën e thirrjes së rë publike nuk ka shfaq interesimin e asnjë personi fizik apo juridik vetëm pasi të ketë mbizotëruar interesi publik dhe përfitimi i komunës. | Ligji Nr. 06/L-092 dhe Rregullorja Nr. 09/2020 nuk parashohin mundësinë e vazhdimit. Me shpalljen/thirrjen publike, shfrytëzuesi aktual duhet të shpreh interesimin përsëri dhe të zhvillohet procedura sërish. |
| | Neni 12. Kontratën me shfrytëzuesin e pronës, objektin, lokali apo hapësirës publikë do të lidhë Komisioni Komunal, e cila kontratë do të nënshkruhet nga Kryetari. | Komisioni ka vetëm rrol vlerësues dhe nuk lidhë kontrata. Vetëm Kryetari mund të lidh kontrata sipas Neni 19, paragrafi 2.1 i Ligjit. |

| | | |
|---|---|---|
| | Neni 14. Toka bujqësore do të jepet në shfrytëzim vetëm për ato produkte një (1) vjeçare | Ky nen është në kundërshtim me Nenin 7 të Rregullores Nr. 09/2020. |

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Pushtetit Lokal, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Skenderajt që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALIPE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. / Br. / No. 463-753/1
Data / Datum / Date 05.11.2020

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government*

| | | |
|---|---|---|
| Za : | **Bekim Jashari**, gradonačelnik opštine Srbica<br>**Fatbardha Haliti**, predsedavajuća Skupštine opštine Srbica | |
| Kopija: | Jedinici za administraciju dokumenata u MLS<br>Jedinici za administraciju dokumenata u opštini | |
| Preko: | **Goran Rakić**, zamenik premijera i ministar MLS<br>**Rozafa Ukimeraj**, generalna sekretarka MLS | |
| Od: | **Venera Qerkini**, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština/ MLS | Datum, 27.10.2020 br. 463-753 |
| Odgovorni službenici:<br>1.Službenik za utvrđivanje zakonske procene<br>2.Službenik-ca za izradu zakonske procene | **Xhevat Tafa**, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština<br><br>**Vjosa Ahmetaj**, viša službenica za montorisanje opština | |
| Predmet: | Zahtev za reviziju zakonitosti akta opštine Srbica | |
| Vrsta akta: | ☐ Odluka Skupštine opštine | |

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.06/2020 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva, Ministarstvo lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine, kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Uredba Skupštine opštine br. 01-110 / 01-0042575 / 20 o davanju na korišćenje imovine, objekata, prostorija i javnih prostora u opštini Srbica do jedne (1) godine |
| Usvojena dana, 29.09.2020. godine, |
| Predložena za razmatranje u MLU, dana, 05.10.2020. godine, |

Ministarstvo lokalne uprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ocenilo je da je, opštinski akt **u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.**

U nastavku možete naći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti:

| Br. | Formulisanje u opštinskom aktu | Zakonska odredba sa kojom je opštinski akt u suprotnosti. |
|---|---|---|
| 1. | Uredba Skupštine opštine br. 01-110 / 01-0042575 / 20 o davanju na korišćenje imovine, objekata, prostorija i javnih prostora u opštini Srbica do jedne (1) godine | Uredba Skupštine opštine br. 01-110 / 01-0042575/20 o davanju na korišćenje imovine, objekata, prostorija i javnih prostora u opštini Srbica do jedne (1) godine je u suprotnosti sa Zakonon br. 06/L-092 o davanja na korišćenje i razmenu opštinske nepokretne imovine, kao i Uredbe (VRK) br. 09/2020 o određivanju postupaka o davanju na korišćenje i razmenu nepokretne opštinske imovine. |
| | Član 5. Davanje na korišćenje nepokretne opštinske imovine do jedne (1) godine | Davanje na korišćenje nepokretne opštinske imovine do jedne (1) godine naporedno sa Zakonom br. 06 / L-092 mora se izvršiti u skladu sa Uredbom br. 09/2020 o određivanju postupaka o davanju na korišćenje i razmene nepokretne imovine opštine. Obuhvatiti stav 1. člana 7. Uredbe. |
| | Član 11. Vreme trajanja ugovora biće sklopljeno u periodu od (1) godine i ne manje od jedne (1) sa mogućnošću produženja za još (1) godinu ako je za imovinu objekat, prostorija ili javni prostor u vreme novog poziva nije izrazilo interesovanje fizičko ili pravno lice tek nakon što je prevladao javni interes i dobit opštine. | Zakon br. 06/L-092 i Uredba br. 09/2020 ne predviđaju mogućnost nastavka. Javnom objavom/pozivom trenutni korisnik mora ponovo da izrazi interes i ponovno odvijanje postupka. |
| | Član 12. Ugovor sa korisnikom imovine, objekta, prostora ili javnog prostora zaključiće Opštinska komisija, a ugovor će potpisati gradonačelnik opštine. | Komisija ima samo ocenjivačku ulogu i ne sklapa ugovore. Samo gradonačelnik može da sklapa ugovore prema članu 19. stav 2.1 zakona. |
| | Član 14. Poljoprivredno zemljište daće se na upotrebu samo za one jednogodišnje proizvode | Ovaj član je u suprotnosti sa članom 7. Uredbe br. 09/2020. |

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo lokalne samouprave *zahteva* od Skupštine opštine i gradonačelnika opštine Srbica, preduzimanje konkretnih mera, kako bi se opštinski akt uskladio sa zakonskim odredbama na snazi, u roku od 30 dana od dana prijema zahteva za reviziju akta.

Ministarstvo lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakvo objašnjenje u vezi sa ovom procenom.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data/Datum/Date: 05. 10. 2020
-01- 463-753

# RREGULLORE PËR DHËNJEN NË SHFRYTZIM DERI NË NJË (1) TË PRONËS, OBJEKTEVE, LOKALEVE DHE HAPËSIARAVE PUBLIKE NË KOMUNËN E SKENDERAJT

Skenderaj

2020

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, ne përputhje me Nr.28/2008) te nenit 14 pika 14.2 shkronja c) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, gjithashtu mbështetur në Ligjin Nr.06/L – 092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, dhe sipas Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, i propozojmë Kuvendit të Komunës qe në mbledhjen e mbajtur me datën 29.09 2020 të miratojë këtë:

# RREGULLORE PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM DERI NË NJË VIT TË PRONËS PUBLIKE NË KOMUNËN E SKENDERAJT

## I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1

### Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qellim të përcaktoj proceduren, dhe kriteret e dhënies në shfrytëzim pronën e paluajtshme të Komunës për interes publik deri në një vit, personave fizik dhe juridik.

### Neni 2

### Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen nga organet e Komunës, nga personat fizik dhe juridik.

### Neni 3

### Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

1.1. Pronë e paluajtshme komunale – nënkupton pronën e paluajtshme, e regjistruar në emër të Komunës, në regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme.

1.2. Dhënia e pronës komunale në shfrytëzim deri në një (1) Vit - nënkupton tokën Lokalet, objektet, hapësirat publike që janë në pronësi të Komunës.

1.3. Komunë - ka kuptimin e përcaktuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale nr.023/L-040.

## PARIMET DHE PROCEDURAT E DHËNIES NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE

### Neni 4

### Parimet e dhënies në shfrytëzim të pronë së paluajtshme komunale

1. Dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim deri në një (1) Vit bëhet nga Komuna përmes komisionit komunal sipas këtyre parimeve.

1.1. Parimi i ligjshmërisë
1.2. Parimi i efikasitetit
1.3. Parimi i trajtimit të barabartë të palëve
1.4. Parimi i transparencës
1.5. Parimi i ruajtjes së interesit publik;
1.6. Parimi i ruajtjes dhe rritjes së vlerës së Pronës, Objektit, Lokalit, Hapësirës publike komunale;
1.7. Parimi i ruajtjes së karakteristikave dhe vlerave unike të pronës;
1.8. Parimi i ruajtjes së mjedisit.

### Neni 5.

### Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale deri në një (1) vit

1. Komuna sipas Nenit 6 pika 3.1 të Ligjit Nr 06/L-92 e ka të drejtën t'i jap ë personave fizik dhe juridik pronën e paluajtshme publike komunale pë shfrytëzim deri në një (1) vit.
2. Të hyrat financiare që realizohen nga dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale, konsiderohen para publike dhe i nënshtrohen legjislacionit për menaxhimin e financave publike dhe financat e pushtetit lokal.

### Neni 6

### Formimi I Komisionit Komunal

1. Kryetari i Komunës nxjerr vendim për formimin e komisionit komunal për dhënien në shfrytëzim deri në një (1) Vit të pronës së paluajtshme komunale për personat fizik dhe juridik duke paraqitur arsyet dhe interesin publik.

2. Komisioni komunal për dhënien në shfrytëzim deri në një (1) Vit të pronës së paluajtshme komunale për personat fizik dhe juridik ka këtë përbërje:

   1. Drejtoria e gjeodezisë një (1) anëtar/e në komision, i cili duhet të jetë kryesues.
   2. Drejtoria e Financave një anëtar/e.

3. Drejtoria e Urbanizmit një anëtar/e
4. Drejtoria e Inspektoriatit Komunal një anëtar/e
5. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Ndërmarrësisë, Inovacionit dhe Turizmit një anëtar/e

3. Komisioni Komunal pas përfundimit të raportit vlerësues duke shprehur qartë arsyen dhe interesin e komunës për dhënien në shfrytëzim deri në një (1) Vit të pronës së paluajtshme komunale për personat fizik dhe juridik, pas përfundimit te afatit te ankesave prej shtatë (7) ditësh, i propozon Kryetarit të Komunës të nënshkruaj kontratë me personin fizik apo juridik mbi parimin e çmimit me te favorshëm për Komunën e Skenderajt, pas nënshkrimit te kontratës Kryetari i Komunës e njofton Kuvendin Komunal për secilin prone të dhënë në shfrytëzim, dhe për secilin pronar te kontraktuar me kushtet e kontratës ne një prej seancave te rregullta por jo me vonë se gjashtë (6) muaj nga dita e nënshkrimit te kontratës.

Neni 7

Procedura dhe Kriteret që Komisioni Komunal duhet të përfill për dhënien e pronës publike komunale në shfrytëzim deri në një (1) Vit.

1. Komisioni komunal cakton kriteret sipas Nenit 5 te Ligjit NR. 06/L - 092.
2. Shpall thirrjen (ankandin) publike ne afat prej shtatë (7) deri në (15) ditësh për pronat, objektet, lokalet, apo hapësirat publike te regjistruara me numra kadastral, te precizuara me madhësi me metra katrore te cilat ipen ne shfrytëzim deri në një (1) vit.
3. Përcakton çmimin fillestar (jo me i vogël se çmimi i tregut ne zonën përkatës ku gjendet prona, objekti, lokali apo hapësira publike).
4. Vlerëson ofertat për të garantuar transparencë hapjen e tyre e bën ne prezencë të palëve konkurrues duke ruajtur parimin e çmimit me të volitshëm (çmimi më i lartë) për Komunën.
5. Përcakton shumën për pjesëmarrje pa kthim për konkurruesit ne konkursin (ankandin) publik.
6. Cakton kohen shtesë te thirrjes publike (jo me shumë se shtatë (7) ditë nëse asnjeri nga konkurruesit nuk i ka përmbushur kriteret minimale për pjesëmarrje në thirrje (ankand) publik sipas kësaj rregulloreje dhe legjislacionit ne fuqi.
7. Vendimi i Komisionit Komunal, duhet të përmbaj por nuk kufizohet:

   7.1. Emrin e shfrytëzuesit të pronës, objektit, lokalit apo hapësirës publike komunale;
   7.2. Aktivitetin që do të ushtrojë në peronën, objektin, lokali apo hapësirës publike komunale;
   7.3. Përshkrimin e peronën, objektin, lokali apo hapësirës publike komunale;
   7.4. Periudhën kohore dhe vendin e pronës objektin, lokali apo hapësirës publike së dhënë në shfrytëzim;

7.5. Obligimet e palës për peronën objektin, lokali apo hapësirës publike komunale që ka ndaj komunës gjatë dhe pas shfrytëzimit.

Neni 8

8.1. Për marrjen e Pronës objektin, lokali apo hapësirës publike në shfrytëzim, kandidati duhet t'i plotësoi këto kushte dhe kritere:

a) Paraqet kërkesën për shfrytëzimin deri në një (1) vit me shkrim ne kohen kur është shpallur thirrja (ankandi) publik e cila duhet te përmbaj te dhëna te sakta për personin fizik dhe juridik, veprimtarinë ekonomike, destinimin shërbimin qe ofron,
b) Paraqet dokumente valide te Republikës se Kosovës,
c) Destinimin e veprimtarisë me çfarë do të merret;

d) Elaboratin mbi arsyshmerinë ekonomike të veprimtarisë;

Neni 9

E drejta në ankesë

1. Sipas Ligjit NR. 06/L-092 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS Neni 20 E drejta në ankesë:
2. Pala e pakënaqur nga procesi i vlerësimit të ofertave nga komisioni, prej ditës së pranimit të njoftimit ka të drejtë të paraqes ankesë brenda shtatë (7) ditë kalendarike në komisionin e ankesave.

2. Komisioni për ankesa në komunë bën shqyrtimin e ankesave brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike.

3. Palët e pakënaqura me vendimin e komisionit të ankesave, brenda afatit ligjor mund të

iniciojnë kontestin administrativ.

Neni 10

Pas informimit të kandidatit për miratimin e ofertës së tij, obligohet ta bëjë nënshkrimin e kontratës.

Neni 11

Kohëzgjatja e kontratës do të bëhet në afat prej një (1) viti e jo me pak se një (1) vit me mundësi të vazhdimit edhe për një (1) vit tjetër nëse për pronën objektin, lokali apo hapësirës publike ne kohen e thirrjes së re publike nuk ka shfaq interesimin asnjë person fizik apo juridik vetëm pasi te ketë mbizotëruar interesi publik dhe përfitimi i komunës.

Neni 12

Kontratën me shfrytëzuesin e pronës, objektin, lokali apo hapësirës publike publike do ta lidhë Komisioni Komunal, e cila kontratë do të nënshkruhet nga Kryetari i Komunës.

## Neni 13

14.1. Pala e cila dëshiron ta shkëpusë kontratën para skadimit të afatit, obligohet qe për këtë ta lajmërojë me shkrim, 60 ditë përpara palën tjetër kontraktuese.

14.2. Komuna e Skenderajt apo Drejtori i Drejtorisë Për Gjeodezi Kadastër dhe pronësi mund ta shkëputë kontratën menjëherë,
për këto raste:

a) Nëse pala fituese në thirrje (ankand) publik që ka lidh kontratë me komunën e shfrytëzon sipërfaqen e Pronës objektin, lokali apo hapësirës publike të dhënë në shfrytëzim, në kundërshtim me dedikimin për të cilin ka paraqitur kërkesë ose që janë pajtuar në kontratë.

b) Nëse pala fituese në thirrje (ankand) publik që ka lidh kontratë me komunën nuk fillon shfrytëzimin e Pronës objektin, lokali apo hapësirës publike, për të cilin i është dhënë në shfrytëzim, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve, nga data e lidhjes së kontratës

## Neni 14

Toka bujqësore do të epet në shfrytëzim vetëm për ato produkte një (1) vjeçare

## Neni 15

Shfrytëzuesi pala përfituese sipas thirrje (ankandit) publik qe ka lidhë kontratë nuk mund të bëjë asnjë renovim, riparimi apo ndryshimi të objektit, lokalit apo hapësirës publik, pa pëlqimin paraprak të Komunës.
Në të kundërtën Komuna do ta shkëputë kontratën dhe pala i bartë të gjitha obligimet.

## Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohen : Kryetari i Komunës, , Drejtorit tjera Kompetente Komunale.

## Neni 16

## Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Skenderajt.

Nr. 01-110/01-0015775/20

Skenderaj, me 21.10. 2020

KOMUNA E SKENDERAJIT

Kryesuesja e Kuvendit Komunal

Znj. Fatbardha Haliti

05-463/01-0039648/20
11.09.2020

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Drejtoria për Gjeodezi Kadaster dhe Pronësi**
**Departament of Geodesy and Property Cadastre**
**Direkcia za Geodeziu Kadaster I Imovi**

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 11.09.2020 |
| REFERENC-Ë: | |
| PËR/ZA/TO: | KOMITETIN PËR POLITIKË DHE FINANCA<br>Kryesuesen z një. Fatbardhë Haliti |
| CC: | Kryetarin e Komunës së Skenderajt<br>z. BEKIM JASHARI |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | Arkivit |
| NGA/OD/FROM: | Drejtori Për Gjeodezi Kadaster dhe Pronësi<br>Ramiz Shala jurist i diplomuar<br>Kryetarë i Komisionit për Statut dhe Rregullore të Komunës së Skenderajt |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | PROPOZIM - VENDIMIN |

Të nderuar anëtarë të K.P. F-së

Me propozimin e Kryetarit të Komunës së Skenderajt z. Bekim Jashari me miratimin e Vendimit te Kuvendit Komunal nr. 01-020/040008861/18. Drejtori i GJKP-së drejton dhe udhëhequr Komisionin për Statut dhe Rregullore të Komunës së Skenderajt Komisioni ka mbajtur takime, në të cilat janë trajtuar gjerësisht aspektet e ndryshimeve dhe plotësimeve që duhet të bëhen në statutin e Komunës Në punën e tij Komisionit për Statut dhe Rregullore të Komunës së Skenderajt ka zbatuar nenin 12 të Ligjit nr. 03/l-040 për vetëqeverisjen lokale, nenit 4, 11, 14, paragrafit 1.7, nenin 15 të **rregullores nr. 01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës (MAPL) dhe nenin 10 të** Udhëzimit administrativ nr. 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative. Ky komision ka hartuar Rregulloren pasi kanë përfunduar edhe afatet ligjore duke realizuar edhe diskutimet publike sipas dispozitave ligjore, është punuar ne komision me profesionalizëm për të bere një Rregullore lehtësisht te kuptueshëm praktikisht te zbatueshëm dhe te përputhshëm plotësisht me legjislacionin e Republikës së Kosovës.

Mbi bazën e legjislacionit ne fuqi është plotësuar çdo afat ligjore si parakusht për procedimin e nevojshëm mbi marrjen e vendimit për miratimin e **RREGULLORE PËR DHËNJEN NË SHFRYTZIM DERI NË NJË VIT TË PRONËS, (LOKALEVE DHE HAPSIARVE TJERA) PUBLIKE NË KOMUNËN E SKENDERAJIT.**

**Ky vendim bën krejtësisht funksional këtë normë komunale e cila është hartuar mbi bazën e ligjshmërisë,**

***Arsyetim:*** Ky PROPOZIM-VENDIM do të shërben për procedimin e më tejmë, rrjedhimisht miratimin e RREGULLORE PËR DHËNJEN NË SHFRYTZIM DERI NË NJË VIT TË PRONËS, (LOKALEVE DHE HAPSIARVE TJERA) PUBLIKE NË KOMUNËN E SKENDERAJIT. dhe pasi që janë përfunduar procedurat ligjore te parapara për diskutim publik ta aprovojmë RREGULLORE PËR DHËNJEN NË SHFRYTZIM DERI NË NJË VIT TË PRONËS, (LOKALEVE DHE HAPSIARVE TJERA) PUBLIKE NË KOMUNËN E SKENDERAJIT pasiqë është nevojë imediate dhe kërkesë krejtësisht ligjore qe Komuna te ketë një Rregullore te tille pasiqe na obligon ligji ne fuqi

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

# RREGULLORE PËR DHËNJEN NË SHFRYTZIM DERI NË NJË (1) TË PRONËS, OBJEKTEVE, LOKALEVE DHE HAPËSIARAVE PUBLIKE NË KOMUNËN E SKENDERAJT

Skenderaj

2020

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, ne përputhje me Nr.28/2008) te nenit 14 pika 14.2 shkronja c) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, gjithashtu mbështetur në Ligjin Nr.06/L – 092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, dhe sipas Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, i propozojmë Kuvendit të Komunës qe në mbledhjen e mbajtur me datën__________ 2020 të miratojë këtë:

# RREGULLORE PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM DERI NË NJË VIT TË PRONËS PUBLIKE NË KOMUNËN E SKENDERAJIT

## I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1

### Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qellim të përcaktoj procedurën, dhe kriteret e dhënies në shfrytëzim pronën e paluajtshme të Komunës për interes publik deri në një vit, personave fizik dhe juridik.

### Neni 2

### Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen nga organet e Komunës, nga personat fizik dhe juridik.

### Neni 3
### Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në ketë Rregullore kanë ketë kuptim:

1.1. Pronë e paluajtshme komunale - nënkupton pronën e paluajtshme, e regjistruar në emër të Komunës, në regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme.

1.2. Dhënia e pronës komunale në shfrytëzim deri në një (1) Vit - nënkupton tokën Lokalet, objektet, hapësirat publike që janë në pronësi të Komunës.

1.3. Komunë - ka kuptimin e përcaktuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale nr.023/L-040.

## PARIMET DHE PROCEDURAT E DHËNIES NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE

### Neni 4
### Parimet e dhënies në shfrytëzim të pronë së paluajtshme komunale

1. Dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim deri në një (1) Vit bëhet nga Komuna përmes komisionit komunal sipas këtyre parimeve.

1.1. Parimi i ligjshmërisë
1.2. Parimi i efikasitetit
1.3. Parimi i trajtimit të barabartë të palëve
1.4. Parimi i transparencës
1.5. Parimi i ruajtjes së interesit publik;
1.6. Parimi i ruajtjes dhe rritjes së vlerës së Pronës, Objektit, Lokalit, Hapësirës publike komunale;
1.7. Parimi i ruajtjes së karakteristikave dhe vlerave unike të pronës;
1.8. Parimi i ruajtjes së mjedisit.

### Neni 5.

### Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale deri në një (1) vit

1. Komuna sipas Nenit 6 pika 3.1 të Ligjit Nr 06/L-92 e ka të drejtën t'i jap ë personave fizik dhe juridik pronën e paluajtshme publike komunale pë shfrytëzim deri në një (1) vit.
2. Të hyrat financiare që realizohen nga dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale, konsiderohen para publike dhe i nënshtrohen legjislacionit për menaxhimin e financave publike dhe financat e pushtetit lokal.

### Neni 6

### Formimi I Komisionit Komunal

1. Kryetari i Komunës nxjerr vendim për formimin e komisionit komunal për dhënien në shfrytëzim deri në një (1) Vit të pronës së paluajtshme komunale për personat fizik dhe juridik duke paraqitur arsyet dhe interesin publik.

2. Komisioni komunal për dhënien në shfrytëzim deri në një (1) Vit të pronës së paluajtshme komunale për personat fizik dhe juridik ka këtë përbërje:

   1. Drejtoria e gjeodezisë një (1) anëtar/e në komision, i cili duhet të jetë kryesues.
   2. Drejtoria e Financave një anëtar/e.

3. Drejtoria e Urbaniznfit një anëtar/e
4. Drejtoria e Inspektoriatit Komunal një anëtar/e
5. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Ndërmarrësisë, Inovacionit dhe Turizmit një anëtar/e

3. Komisioni Komunal pas përfundimit të raportit vlerësues duke shprehur qartë arsyen dhe interesin e komunës për dhënien në shfrytëzim deri në një (1) Vit të pronës së paluajtshme komunale për personat fizik dhe juridik, pas përfundimit te afatit te ankesave prej shtatë (7) ditësh, i propozon **Kryetarit të Komunës** të nënshkruaj kontratë me personin fizik apo juridik mbi parimin e çmimit me te favorshëm për Komunën e Skenderajt, pas nënshkrimit te kontratës **Kryetari i Komunës** e njofton **Kuvendin Komunal** për secilin prone të dhënë në shfrytëzim, dhe për secilin pronar te kontraktuar me kushtet e kontratës ne një prej seancave te rregullta por jo me vonë se gjashtë (6) muaj nga dita e nënshkrimit te kontratës.

## Neni 7

**Procedura dhe Kriteret që Komisioni Komunal duhet të përfill për dhënien e pronës publike komunale në shfrytëzim deri në një (1) Vit.**

1. Komisioni komunal cakton kriteret sipas Nenit 5 te Ligjit NR. 06/L – 092.
2. Shpall thirrjen (ankandin) publike ne afat prej shtatë (7) deri në (15) ditësh për pronat, objektet, lokalet, apo hapësirat publike te regjistruara me numra kadastral, te precizuara me madhësi me metra katrore te cilat ipen ne shfrytëzim deri në një (1) vit.
3. Përcakton çmimin fillestar (jo me i vogël se çmimi i tregut ne zonën përkatës ku gjendet prona, objekti, lokali apo hapësira publike).
4. Vlerëson ofertat për të garantuar transparencë hapjen e tyre e bën ne prezencë të palëve konkurrues duke ruajtur parimin e çmimit me të volitshëm (çmimi më i lartë) për Komunën.
5. Përcakton shumën për pjesëmarrje pa kthim për konkurruesit ne konkursin (ankandin) publik.
6. Cakton kohen shtesë te thirrjes publike (jo me shumë se shtatë (7) ditë nëse asnjeri nga konkurruesit nuk i ka përmbushur kriteret minimale për pjesëmarrje në thirrje (ankand) publik sipas kësaj rregulloreje dhe legjislacionit ne fuqi.
7. Vendimi i Komisionit Komunal, duhet të përmbaj por nuk kufizohet:

   7.1. Emrin e shfrytëzuesit të pronës, objektit, lokalit apo hapësirës publike komunale;
   7.2. Aktivitetin që do të ushtrojë në peronën, objektin, lokali apo hapësirës publike komunale;
   7.3. Përshkrimin e peronën, objektin, lokali apo hapësirës publike komunale;
   7.4. Periudhën kohore dhe vendin e pronës objektin, lokali apo hapësirës publike së dhënë në shfrytëzim;

7.5. Obligimet e palës për peronën objektin, lokali apo hapësirës publike komunale që ka ndaj komunës gjatë dhe pas shfrytëzimit.

## Neni 8

8.1. Për marrjen e Pronës objektin, lokali apo hapësirës publike në shfrytëzim, kandidati duhet t'i plotësoi këto kushte dhe kritere:

a) Paraqet kërkesën për shfrytëzimin deri në një (1) vit me shkrim ne kohen kur është shpallur thirrja (ankandi) publik e cila duhet te përmbaj te dhëna te sakta për personin fizik dhe juridik, veprimtarinë ekonomike, destinimin shërbimin qe ofron,

b) Paraqet dokumente valide te Republikës se Kosovës,

c) Destinimin e veprimtarisë me çfarë do të merret;

d) Elaboratin mbi arsyshmerinë ekonomike të veprimtarisë;

## Neni 9

## E drejta në ankesë

1. Sipas Ligjit NR. 06/L-092 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS Neni 20 E drejta në ankesë:

2. Pala e pakënaqur nga procesi i vlerësimit të ofertave nga komisioni, prej ditës së pranimit të njoftimit ka të drejtë të paraqes ankesë brenda shtatë (7) ditë kalendarike në komisionin e ankesave.

2. Komisioni për ankesa në komunë bën shqyrtimin e ankesave brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike.

3. Palët e pakënaqura me vendimin e komisionit të ankesave, brenda afatit ligjor mund të

iniciojnë kontestin administrativ.

## Neni 10

Pas informimit të kandidatit për miratimin e ofertës së tij, obligohet ta bëjë nënshkrimin e kontratës.

## Neni 11

Kohëzgjatja e kontratës do të bëhet në afat prej një (1) viti e jo me pak se një (1) vit me mundësi të vazhdimit edhe për një (1) vit tjetër nëse për pronën objektin, lokali apo hapësirës publike ne kohen e thirrjes së re publike nuk ka shfaq interesimin asnjë person fizik apo juridik vetëm pasi te ketë mbizotëruar interesi publik dhe përfitimi i komunës.

## Neni 12

Kontratën me shfrytëzuesin e pronës, objektin, lokali apo hapësirës publike publike do ta lidhë Komisioni Komunal, e cila kontratë do të nënshkruhet nga Kryetari i Komunës.

**Neni 13**

14.1. Pala e cila dëshiron ta shkëpusë kontratën para skadimit të afatit, obligohet qe për këtë ta lajmërojë me shkrim, 60 ditë përpara palën tjetër kontraktuese.

14.2. Komuna e Skenderajt apo Drejtori i Drejtorisë Për Gjeodezi Kadastër dhe pronësi mund ta shkëputë kontratën menjëherë, për këto raste:

a) Nëse pala fituese në thirrje (ankand) publik që ka lidh kontratë me komunën e shfrytëzon sipërfaqen e Pronës objektin, lokali apo hapësirës publike të dhënë në shfrytëzim, në kundërshtim me dedikimin për të cilin ka paraqitur kërkesë ose që janë pajtuar në kontratë.

b) Nëse pala fituese ne thirrje (ankand) publik që ka lidh kontratë me komunën nuk fillon shfrytëzimin e Pronës objektin, lokali apo hapësirës publike, për të cilin i është dhënë në shfrytëzim, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve, nga data e lidhjes së kontratës

**Neni 14**

Toka bujqësore do të epet në shfrytëzim vetëm për ato produkte një (1) vjeçare

**Neni 15**

Shfrytëzuesi pala përfituese sipas thirrje (ankandit) publik qe ka lidhë kontratë nuk mund të bëjë asnjë renovim, riparimi apo ndryshimi të objektit, lokalit apo hapësirës publik, pa pëlqimin paraprak të Komunës.
Në të kundërtën Komuna do ta shkëputë kontratën dhe pala i bartë të gjitha obligimet.

**Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohen : Kryetari i Komunës, , Drejtorit tjera Kompetente Komunale.

**Neni 16**

**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Skenderajt.

**Nr.________________**

**Skenderaj, me __/.__/. 2020**

**KOMUNA E SKENDERAJIT**

**Kryesuesja e Kuvendit Komunal**

**Znj. Fatbardha Haliti**

Nr. 01-463/01-0030358/20
Data 03.08.2020

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opstine/Municipal Assambly

Në bazë të nenit 12 par 1, 2 shkronja c), dhe nenit 40 par. 1, 2 shkronja a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, qershor 2008, neni 18 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna dhe neni 14 par. 1, 2 shkronja c) të Statutit të Komunës së Skenderajt nr. 01-110-385, i dt.03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 29.07.2020 miratoi këtë:

# VENDIM

Për Vënien në Diskutim Publik të Draft Rregullores për Dhënien në Shfrytëzim deri në një (1) vite të pronës, objekteve, lokaleve dhe hapësirave publike në Komunës e Skenderajt

**Neni 1**

Miratohet propozim-vendimi me nr.01-463/01-0027508/20, e dt.21.07.2020, për Vënien në Diskutim Publik të Draft Rregullores për Dhënien në Shfrytëzim deri në një (1) vite të pronës, objekteve, lokaleve dhe hapësirave publike në Komunës e Skenderajt.

**Neni 2**

Draft -Rregullorja si në pikën I të këtij vendimi do të jetë në diskutim publik 30 ditë duke filluar nga data 03.08.2020, gjerë më datën 03.09.2020.

**Neni 3**

Brenda këtij afati ligjor të diskutimit publik, ftohen të gjithë qytetaret e Komunës së Skenderajt, personat fizik dhe juridik, që të kontribuojnë në këtë proces.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komisionit për Statut dhe Rregullore z.Ramiz Shala

**Neni 5**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe publikimit të tij në ueb – faqen e Komunës.

**Vendimi i Dërgohet :**
1x1 Arkivit;
1x1 MAPL-së;
1x1 Zyrës së Kryetarit;
1x1 Tabelës së Shpalljeve Publike;
1x1 Komisionit për statut dhe rregullore;
1x1 Dosjes.

Kryesuesja e KK-së;
znj. Fatbardha Haliti

Nr. 01-110/01-0038415/20
Data 04.09.2020

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komunna Skenderaj
Opstine Srbica
Municipality of Skenderaj

Në bazë të nenit 12 të Ligjit nr. 03/l-040, nenit 4, 11, 14, paragrafit 1.7, nenit 15 të rregullores nr. 01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës (MAPL) dhe nenin 10 të Udhëzimit administrativ nr. 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative, sipas vendimit të Kuvendit Komunal numër 01-020/040008861/18, Komisioni Komunal për Statut dhe Rregullore në Komunën e Skenderajt me datë 26./ 08./ 2020 në ora 14:00 në sallën e Qendrës së Kulturës "HASAN PRISHTINA" është mbajtur Diskutimi Publikë i cili paraqitët në këtë:

## RAPORT

### për Diskutim Publik për Projekt – Rregulloren e Komunës së Skenderajt për Dhënien në Shfrytëzim Deri në një Vit të Pronës, (Lokaleve dhe Hapësirave tjera) në Komunën e Skenderajt Publikë

I. Diskutimi Publikë ka filluar me kohë, fillimisht në një rezyme të shkurtër para qytetarëve për punën e komisionit dhe angazhimin e tije në Hartimin e Projekt – Rregulloren e Komunës së Skenderajt për Dhënien në Shfrytëzim Deri në një Vit të Pronës, (Lokaleve dhe Hapësirave tjera) në Komunën e Skenderajt Publikë Metodologjia e përdorur, legjislacioni i konsultuar etj.

II. Në këtë Diskutim Publik kanë marrë pjesë sipas evidencës së mbajtur pesëdhjetë (50) .qytetarë te të dy gjinive, të moshave dhe profesioneve të ndryshme me q 'rast kanë dhënë mendimet e tyre për çështjet që duhet të përmbaj Statuti i Komunës së tyre

III. Ky raport është i nxërurr vetëm për Diskutimin Publikë sipas njoftimit numër 02-110/04-0030494/20 te datës 04./ 08./ 2020, ndërsa raporti përfundimtarë i punës së Komisionit Komunal për Statut dhe Rregullore do të arkivohet dhe publikohet pasi të jetë miratuar Statuti dhe rregullorja në Kuvendin Komunal të Skenderajt në njërën nga seancat e Kuvendit.

Ramiz Shala
Jurist i Diplomuar

Kryetar i Komisionit

*I dërgohet:*
*-Arkivit te Komunes.*
*- Sekretarise se Kuvendit dhe anëtareve të Komisionit*
*- Kabinetit te Kryetarit dhe Zyrës së Informimit.për publikim*

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Skenderajt
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

# PROCESVERBAL I DISKUTIMIT PUBLIK PËR RREGULLOREN KOMUNALE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE DERI NË NJË VIT

Me datën 26.08.2020
Ora 15:00

Me datën 26.08.2020 në Objektin e Qëndres së Kulturës në Skenderaj u mbajt diskutimi publik me qytetarë për "Rregulloren komunale për dhënien në shfrytëzim të pronës së komunës deri në një vit".

Të pranishëm në sallë ishin Komisioni i përbërë nga:

Ramiz Shala -Kryetar i Komisionit;
Ibush Hetemi -Anëtar;
Përparim Gruda -Anëtar;
Sokol Sallahu- Anëtar;

Të pranishëm ishin 52 qytetarë në këtë dëgjim publik të "Rregullores komunale", ndërsa më këtë rast Kryetari i Komisionit për "Rregulloren komunale për dhënien në shfrytëzim të pronës së komunës deri në një vit" hapi debatin me qytetarë dhe prezantoj draftin.

Qytetarët parashtruan pyetjet dhe rekomandimet e tyre rreth "Rregullores komunale" ndërsa Komisioni mbajti procesverbal duke ju siguruar se rekomandimet e tyre do të shqyrtohen me kujdes dhe do të bëhen të gjitha plotësim ndryshimet e arsyeshme.

Procesmbajtësi: Sokol Sallahu________________

Me propozimin e Kryetarit të Komunës së Skenderajt z. Bekim Jashari me miratimin e Vendimit te Kuvendit Komunal nr. 01-020/040008861/18. Drejtori i GJKP-së drejton dhe udhëhequr Komisionin për Statut dhe Rregullore të Komunës së Skenderajt Komisioni ka mbajtur takime, në të cilat janë trajtuar gjerësisht aspektet te ndryshme te normës Juridike.

Në punën e tij Komisionit për Statut dhe Rregullore të Komunës së Skenderajt ka zbatuar nenin 12 të Ligjit nr. 03/l-040 për vetëqeverisjen lokale, nenit 4, 11, 14, paragrafit 1.7, nenin 15 të **rregullores nr. 01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës (MAPL) dhe nenin 10 të** Udhëzimit administrativ nr. 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative. Ky komision ka hartuar Statutin pasi kanë përfunduar edhe afatet ligjore duke realizuar edhe diskutimet publike sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Në diskutim publik janë DRAFT / STATUTIN DHE RREGULLORJA te cilin ne mënyrë përmbajtsorë, lehtësisht te kuptueshëm praktikisht te zbatueshëm dhe te përputhshëm plotësisht me legjislacionin e Republikës së Kosovës.

| EMRI | MBIEMRI | TELEFONI | E-mailadresa | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| RAMIZ | SHALA | 049 19 35 75 | Ramiz.r.shala@rks-gov.net | |
| Ibush | Hetemi | 044-192-199 | [illegible] gov.net | |
| Sokol | Sallahu | 044-359-[illegible] | Sokol.Sallahu@rks-gov.net | |
| PERPARIM | GRUDA | 045-2[illegible]6[illegible] | [illegible] .net | |
| MUSA | HAJDARI | | | |
| FATLUME | KODRA | | | |
| VJOLLCA | RAMADANI | | | |

Mbledhja mbahet me datë 26/ 08 / 2020 me fillim ne ora 14:00 ne objektin e qendrës se kulturës ne Skenderaj.

Me firmën e tyre te gjithë natarët e komisionit dëshmojnë prezencën dhe pajtueshmërinë me punën e komisionit nëse ne mënyrë shpërthimorë nuk e trajnojnë ndryshe apo paraqesin me shkrin pran komisionit një propozim konkret për ndonjë qeshje apo nen statutit për te cilin ndajnë mendim.